



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 05**

Datë: 04. 02. 2022. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Valmira Selmani, drejtoresh, ud.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

**RENDI I DITËS**

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve Nr. 87, 88, 89 dhe 90 /2021:**
- 3. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

**Këshilli për Çështje Ligjore:**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Ferizaj.

**Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të shpenzimeve të derivateve janar-dhjetor 2021.

- 4. Të ndryshme.**

### **1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

**Kreshnik Radoniqi:** Sot, mungojnë Gordana dhe Rifati, të tjerët janë prezentë. E keni rendin e ditës para jush. Rendi i ditës miratohet, dhe pastaj edhe procesverbalet nr. 87, 88, 89 dhe 90 /2021, me abstenimin e dy procesverbaleve në të cilat, z. Kurteshi nuk kishte marrë pjesë ne mbledhje.

### **2.Raport i Këshillave të KQZ-së**

#### **Këshilli për Çështje Ligjore:**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Ferizaj:

**Sami Kurteshi,** e njoftoi KQZ-në lidhur me takimin e këtij këshilli, e ku ishte një pikë e rendit të ditës: zëvendësimi i një asamblisti në Ferizaj. Pas çdo shqyrtimi të nevojshëm, qoftë nga zyra ligjore dhe qoftë nga këshilli, janë plotësuar kushtet për zëvendësim, tha z. Kurteshi.

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Ferizajt, i dorëhequri Ismet Vranovci, zëvendësohet nga Flamur Istrefi nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Miratohet me vota unanime.

### **3.Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të shpenzimeve të derivateve janar-dhjetor 2021.

**Ilir Gashi:** Në mungesë të kryesueses, tha z. Gashi, ai e ka udhëhequr mbledhjen. Dhe, fillimisht, është shqyrtuar dhe miratuar raportit të shpenzimeve të derivateve janar-dhjetor 2021. Ne, rekomandojmë për miratim...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë raport me vota unanime.

### **4.Të ndryshme!**

**Alim Rama,** diskutoi në lidhje me punëtorinë për planin e punës së KQZ. Ne, kishim kërkesë në DOZ që të përgatitet raporti përpara se të fillonte punëtorja, por atë raport ende se kemi. Pra, së pari ishte kërkesë që, ne të kishim një pasqyrë përpara që t'i jepnim ne mendimet, vërejtjet, rekomandimet...

Por, edhe a ka pas kërkesë të EOM-i që të ketë një takim të KQZ-së, se pse ka ndodhë lëvizja e punëtorisë, edhe pse ka pasur kërkesë të vëzhguesve...

**Kreshnik Radoniqi**: Sa di unë, shumica e anëtarëve ishin dakord që punëtorja të mbahej gjatë javës, jo gjatë vikendit...Kurse, për raportin krye shefi mund të na njoftoj...

Sa i përket takimit, nuk ka kaluar nëpër këshillin për marrëdhënie me jashtë. Ka qenë një kërkesë për me dorëzuar raport, dhe unë jam takuar dhe pas takimit ua kam përcjellë me imell raportin. Nëse mendoni që, ishte dashur të diskutohet në këshill, atëherë e bëjmë në të ardhmen, në rastet tjera por këtë se kam menduar siç, thoni ju...

**Burim Ahmetaj**: Ne, jemi ende jemi duke e shqyrtuar planin e vitit 2021, por e di që ka kërkuar DOZ dhe sapo ta mbarojmë, e dorëzojmë edhe në KQZ sepse, është pikë e veçantë në punëtori... Por, mendoj që duhet ta kenë raportin edhe anëtarët e KQZ-së para mbledhjes...

**Arianit Elshani**: Po, ne ishim dakord në DOZ me agjendën e punëtorisë. Dhe, aty figurojnë këto çështje. Nuk e di se kur do ta kemi këtë raport në lidhje me implementimin e planit të punë së vitit 2021, por unë mendoj që sot ishte dashur ta kemi materialin...pra, edhe raportin e vëzhguesve të OEMI-t...

Me të drejtë po ngritët çështja, mbase nga KOZ-i dhe, të jemi të kompletuar me materiale përgjatë punëtorisë...

**Alim Rama**: Pra, punëtorja u shtye, dhe mendoj që edhe në takim me vëzhguesit ishte dashur me qen dikush nga anëtarët e KQZ-së...Në anën tjetër, sot e premtë dhe ne fillojmë të hënën me punëtorinë, dhe nuk e kemi materialin e kompletuar...

Pra, ne nuk mund të humbim kohë se, ndryshe nuk na mbetet shumë kohë me diskutua për planin e punës së këtij viti...

**Burim Ahmetaj**: Besoj, sot ua përcjellim raportin mbas mbledhjes...

**Sami Kurteshi**, shumë mirë që diskutojmë, tha ai, mirëpo pse po vinë me vonësë dokumentet në momentin e fundit...s'i edhe tjerat për shembull "raporti financiarë"... etj.

Ne, sa problem me votue por, ne duhet t'i shqyrtojmë përpara dokumentet, të bëjmë analiza, t'i japim vërejtët e tona...

Pra, çështja është t'i bëjmë punët mirë, të kemi kohë sepse punët shpejtë nuk bëhen...! Ka pasur kohë, mirëpo ja tani vjen në momentet e fundit...Unë po them që, ju lutem që dokumentet që janë afatgjatë, të planifikuar të sillen me kohë...Njësoj, si edhe puna e procesverbalet...

Sidomos kur është fjala për dokumente që kanë vëllim, është me rëndësi që të kemi kohë ti shqyrtojmë, ti analizojmë etj...

**Alim Rama**: Sekretariati, duhet t'i marrë me kohë veprimet e veta, të mos na përsëriten çështjet, si për shembull procesverbalet...

**Për KQZ**

**Kreshnik Radoniqi, kryetar**

-----